



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e IV-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12 prill 2023 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 11:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Nurie Halili, Lorik Mëxhuni, Agron Perçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia, (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Shpëtim Zhegrova (Nënkryetar i Komunës), drejtorët e drejtorive, Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore, si dhe Bastri Duraku e Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – lidhur me pikën 2, ai deklaroi se raportin nuk kemi pasur mundësi t'ua sjellim me kohë për shkak se zyrtari kryesor financiar ka qenë në pushim, kurse drejtorët financiar nuk kanë qasje në raportim. Por, ai tha se sapo të përgatitet ky raport do t'ua përcjellim përmes postës elektronike.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë vota “për” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.3.2023;
2. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së ndërmarrjes regjionale të mbeturinave “Uniteti” për vitin 2022;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së ndërmarrjes regjionale të ujësjellësit “Mitrovica” për vitin 2022;
5. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e komunës së Vushtrrisë të shkaktuara në muajin mars 2023;
6. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.3.2023.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 15.3.2023.

2. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se pasi që mungon materiali, e kemi arsyetimin e drejtorit dhe konsideroj se duhet ta procedojmë për kuvend, sepse për mbledhjen e kuvendit do ta kemi materialin.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – tha se pajtohet me sqarimin e drejtorit. Ky rast është mirë se në mbledhjen e kaluar, ku na erdhi një material për bartjen e të hyrave me të dhëna të nga KPF-ja në kuvend, ku të dhënat nuk përputheshin.

Sylejman Mehल्ली, anëtar i KPF-së – deklaroi se mund të kemi mirëkuptim sa i përket vonesave teknike. Por, kur ka çështje të rëndësishme, siç është ky raport, nuk është dashur fare t'i miratohet pushimi zyrtarit kryesor financiar, pa u përfunduar ky raport. Prandaj, nuk mund të votojë për procedim në kuvend të raportit, për të cilin nuk kemi material dhe të mbajë përgjegjësi për diçka që nuk e kam parë dhe kërkoi mirëkuptim për këtë.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për”, një (1) “kundër” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së ndërmarrjes regjionale të mbeturinave “Uniteti” për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së ndërmarrjes regjionale të ujësjellësit “Mitrovica” për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e komunës së Vushtrisë të shkaktuara në muajin mars 2023.

Sylejman Mehल्ली, anëtar i KPF-së – deklaroi se në mbledhjen e kaluar të KPF-së dhe kuvendit e kemi miratuar një raport të tillë. A janë këto raste të reja?

Maliq Ferizi, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim – tha se kemi dy raste të reja nga vërshimet që kanë ndodhur në muajin mars 2023.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën **11:20**.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi

Kryesuese e KK-së dhe KPF-së

